



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE**

NR. 635/12 PROT., DATË 09.12.2022



Republika e Maqedonisë së Veriut
Enti Shtetëror i Statistikës

**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË
VERIUT
ENTI SHTETËROR I STATISTIKAVE
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT**

NR. 34-2138/1 PROT., DATË 12.12.2022

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

mbi bashkëpunimin

ndërmjet Institutit të Statistikave të Shqipërisë (INSTAT)

dhe Entit Shtetëror të Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut (SSO)

Instituti i Statistikave të Shqipërisë dhe

Entit Shtetëror të Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

në vijim të referuar si “Palët” kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1

Objekti

Palët do të bashkëpunojnë me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit statistikor.

Neni 2

Dispozita të përgjithshme

2.1. Ky memorandum përfaqëson një shprehje vullnetare të qëllimit të palëve për të punuar së bashku në fushën e statistikave për të promovuar efikasitetin e njohurive.

- 2.2. Memorandumi krijon një kornizë të përgjithshme dhe dispozita për një bashkëpunim efikas. Ai mbështet një sërë aktivitete dhe promovon përcaktimin e objektivave dhe procedurave të bashkëpunimit të ndërsjelltë për shkëmbimin e informacionit, pikëpamjeve dhe përvojave me qëllim që të lehtësojë zhvillimet dhe zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta statistikore.

Neni 3

Fushat e Bashkëpunimit

- 3.1. Në kuadër të bashkëpunimit, palët synojnë të punojnë së bashku në fushat statistikore të miratuara reciprokisht.
- 3.2. Në parim, të gjitha temat statistikore janë fusha potenciale për veprim në kuadër të këtij Memorandumi. Përzgjedhja e temave specifike është çështje e marrëveshjeve të ndërsjella në të ardhmen.
- 3.3. Palët vendosin të kryejnë aktivitete të përshtatshme për zbatimin objektiv, si shkëmbimi i praktikave më të mira, shkëmbimi i përvojës, krijimi i rrjeteve, etj. Për më tepër, ky bashkëpunim do të promovojë sjelljen profesionale në përputhje me Parimet Themelore mbi Statistikat Zyrtare të Kombeve të Bashkuara dhe Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane dhe do të krijojnë një forum për shkëmbimin e përvojës ndërmjet dy palëve.

Neni 4

Çështje të tjera kontraktuale dhe financiare

- 4.1. Në përputhje me dispozitat e këtij Memorandumi, detyrat përkatëse për çdo aktivitet dhe asistencë përkatëse e ekspertëve (numri i ekspertëve, programi i punës, kohëzgjatja dhe kompensimi) do të përcaktohen nga Palët përpara çdo aktiviteti ose asistence në formën përkatëse në varësi të mënyrës së financimit të aktiviteteve.
- 4.2. Aktivitetet e përbashkëta janë në përputhje me programet përkatëse kombëtare dhe mund të financohen nga buxheti i shtetit përkatës ose nga një prej projekteve të financuara nga BE, ose nga mekanizma të tjerë të disponueshëm për zhvillimin e statistikave. Financimi i aktiviteteve do të përcaktohet rast pas rasti.

Neni 5

Çështjet Ligjore

- 5.1. Aktivitetet e bashkëpunimit të bazuara në këtë Memorandum nuk çenojnë legjislacionin kombëtar për sigurinë, konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe individuale të personave fizikë dhe juridikë.
- 5.2. Ky Memorandum nuk përbën një marrëveshje ndërkombëtare dhe për rrjedhojë nuk gjeneron të drejta apo detyrime sipas ligjit ndërkombëtar.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha konfliktet, mosmarrëveshjet ose diferencat në interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhen përmes konsultimeve ndërmjet dy Palëve.

Neni 7

Hyrja në fuqi, përfundimi dhe ndryshimi

7.1. Ky memorandum hyn në fuqi me nënshkrimin e tij dhe lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila palë mund të përfundojë këtë Memorandum duke i dërguar palës tjetër një njoftim me shkrim për anulimin. Në atë rast, Memorandumi do të pushojë së qeni i vlefshëm 90 ditë nga marrja e njoftimit për përfundimin e Memorandumit.

7.2. Ky memorandum mund të ndryshohet me pëlqimin me shkrim të të dy Palëve.

Nënshkruar në Tiranë dhe Shkup, në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe, maqedonase dhe angleze ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast konflikti në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Instituti i Statistikave të Shqipërisë

Drejtori i Përgjithshëm

Elsa Dhuli

The block contains a handwritten signature in blue ink, which appears to be 'E. Dhuli'. To the right of the signature is a circular official stamp. The stamp features the coat of arms of Albania in the center. The text around the coat of arms reads 'INSTITUTI I STATISTIKAVE TË SHQIPËRISË' at the top and 'TIRANË' at the bottom.

**Enti Shtetëror i Statistikave të
Republikës së Maqedonisë së
Veriut**

Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar

Apostol Simovski

The block contains a handwritten signature in blue ink, which appears to be 'A. Simovski'. To the right of the signature is a circular official stamp. The stamp features the coat of arms of North Macedonia in the center. The text around the coat of arms reads 'REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT' at the top and 'STATISTIKA' at the bottom.